

UDHEZUES

“Çfare tani: Pertej Programit te Shkembimit te Sipermarresve te Rrinj”

“What now: Beyond the EYE Exchange”

Erasmus for Young Entrepreneurs



Dega NOA



068 400 1403



noafin.al



noa.financojme

An initiative funded and supported by the European Union



SHENIM

Ky udhezues u realizua si pjese e projektit: **"Entrepreneurs Sharing and Training Network 3"** ne kuader te programit: Erasmus per Sipermarresit e Rinj (Erasmus for Young Entrepreneurs - EYE)



PERMBLEDHJE

1. HYRJE – PERTEJ PROGRAMIT TE SHKEMBIMIT	4
1.1 NOA SHA	5
1.2 TRAJNIME	12
1.3 PREZANTONI DHE SHPERNDAJENI TEK TE TJERET PROJEKTIN TUAJ	13
2. MUNDESITE PER SIPERMARRËSIT TE CILAT JANE TE LIDHURA ME PROGRAMIN .	13
2.1 EYE ALUMNI NETWORK	13
2.2 ENTERPRISE EUROPE NETWORK	14
3. ZHVILLIMI I QENDRUESHEM I NJE BIZNESI	15
3.1 KLIMA E TE BERIT BIZNESIT DHE MBESHTETJA PER NVM-TE NE SHQIPERI.....	15
3.2 NEVOJAT DHE BURIMET E FINANCIMIT, PERGJEGJESITE DHE AFATET PER SIPERMARRJET NE SHQIPERI	17
3.3 ZHVILLIMI I SIPERMARRJEVE SOCIALE NE SHQIPERI DHE KRAHASIMI ME BE	18
3.4 MUNDESITE PER FINANCIM DHE FORMA TE TJERA TE MBESHTETJES PER SIPERMARRJET NE TERESI DHE SIPERMARRJET SOCIALE NOVATORE	20
3.5 MUNDESI ALTERNATIVE PER FINANCIM.....	22



1. HYRJE – PERTEJ PROGRAMIT TE SHKEMBIMIT

Ky udhezues synon te sherbeje si nje mjet praktik per te mbështetur sipermarresit e rinj pas realizimit te programit te shkembimit. Si nje referim ky udhezues ka edhe programin e rrjetit EYE ALUMNI (Erasmus for Young Entrepreneurs Alumni).

Ne veçanti do ti kushtohet vemendje e veçante mundesive qe ju ofrohet sipermarresve te rrinj nga institucone te ndryshme ne vend si dhe institucione nderkombetare duke ofruar njohuri te pergjithshme mbi tendencat me te reja (digitalizimin, ekonomine e gjelbert, ekonomine e qendrushme dhe ekonomine sociale).

Gjithashtu ne kete material do te perfshihet edhe informacioni mbi mundesite alternative te financimit (institucionet financiare jo banka, mikrofinanca, crowdfunding, financa sociale dhe investimet me ndikim).

Ne boten moderne te sipermarrjes eshte thelbesore te mbeshteten sipermarresit e rinj dhe ata aspirante (te ardhshem) te cilet kane shtigjet e mirepercaktuara dhe te pershtatura per te garantuar njerezit dhe veçanerisht te rinjte, te cilet jane dhe kuptimi i vertete i termit "sipermarrje".

Ky udhezues ofron ide konkrete per mbeshtetje pas perfundimit te programit te shkembimit Erasmus for Young Entrepreneurs "Pertej programit te shkembimit" dhe eshte ideuar si nje mjet bazik qe do ti ofrohet sipermarresve te rrinj nga NOA.



1.1 NOA SHA

NOA është një Institucion Financiar Jo Banke i krijuar më 30 Dhjetor 1998, nga USAID me emrin fillestar "Partner Shqiptar për Mikrokredi" (PSHM). Më 2 Mars 2001, u shndërrua në Shoqëri Aksionare (SH.A.) për t'u riemërtuar si NOA sh.a. më 11 Prill 2011. U licencua nga Banka Qendrore e Shqipërisë si Institucion Financiar Jo Banke plotësisht i pavarur në muajin Qershor 2007.

Që nga viti 1998, NOA shërben si një institucion financiar gjithëpërfshirës duke dhënë kredi dhe duke ofruar shërbime këshillimore për startup-et, bizneset e vogla, fermerët dhe familjet që kanë akses të kufizuar ose nuk kanë akses në shërbimet tradicionale bankare, për shkak të mungesës së kolateralit, të ardhurave të ulta, aktivitetit rural ose statusit fillestar.

NOA ka një portofol kredie prej rreth 14,400 kliente aktive, me vlerë 71 milion euro dhe rreth 319 të punësuar.

Misioni kryesor i NOA është të mbështesë krijimin e vendeve të punës, aksesin në financa dhe rritjen e mirëqenies së familjeve shqiptare. NOA përdor një infrastrukturë moderne IT dhe zgjidhje të reja të komunikimit nëpërmjet të celularit.

Përveç kësaj, ajo ka një staf profesionist që ofron dhe promovon shërbime të cilësive së lartë ndaj klientit, shërbime të shpejta dhe siguri. Portofoli i kredive së NOA-s është i larmishëm dhe përfshin disa produkte kredie si: Eficienca e Energjisë, Investimet në Kapital Punë, kredi të shpejta për biznesin, kredia flex, kredi për startup-e, kredi për agrobiznesin dhe kredi për individë dhe familje etj.

NOA Shqiperi ka themeluar së fundmi NOA Kosovë, duke u licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës më 27.02.2023. NOA Kosovë është një filial i zotëruar me shumicë të aksioneve nga NOA Shqiperi.

Bazuar në strategjinë e saj të zgjerimit dhe modelin e suksesshëm të biznesit, NOA Shqiperi ka zgjedhur tregun e Kosovës për të ofruar produkte konkurruese kreditimi, pa kolateral, si një mëjet për t'iu përgjigjur kërkesës së lartë të klientëve në një kohë rekord. Zyrtar Qendrore të NOA-s në Kosovë janë me seli në Prishtinë dhe ofrojnë kredi mikro dhe të vogla në tregun e Kosovës për kategoritë e klientëve të synuar si: bizneset mikro dhe familjare; fermerët dhe agrobizneset, familjet dhe individët, duke synuar një mbështetje me procedurë të shpejta dhe



fleksibel te kredidhenies me qellim realizimin e planeve te investimit te klienteve te saj ne kohe te shpejte.

Synimi kryesor i NOA Shqiperi dhe NOA Kosove eshte permiresimi i jetes se qytetareve duke permbushur ambiciet e tyre per zhvillim financiar, nepermjet vetepunesimit, zhvillimit te pronave familjare bujqesore, krijimit te nje biznesi te vogel apo zgjerimit te aktivitetit sipermarres.

Misioni i NOA-s eshte te fuqizojë bizneset, fermeret dhe familjet, duke qene nje partner afatgjat i klienteve te saj ne rrugetimin e tyre sipermarres, duke i mbeshtetur ata per te zhvilluar me tej ambiciet e tyre dhe per te permbushur endrrat e tyre sipermarrese.

NOA ofron nje sistem teknologjik bashkekohor duke u ofruar klienteve lehtesira per perfshirje financiare nepermjet te kanaleve te ndryshme (Online, Rrjetit te Partnereve te Biznesit, prane ambienteve ne te gjithë deget e saj fizike, nepermjet te kompanive te tjera financiare apo fintech, etj.).

NOA eshte **anetare** e disa institucioneve te rendesishme kombetare dhe nderkombetare si:

1. **RRJETI EVROPIAN I MIKROFINANCES (EMN)**: eshte nje organizate jofitimpruese me seli ne Bruksel, e cila promovon mikrofinancen si nje mjet per te luftuar perjashtimin social dhe financiar ne Evrope permes vetepunesimit dhe krijimit të mikrndermarrjeve. Misioni i Rrjetit eshte te lehtesoje ndertimin e kapaciteteve dhe te avokoje ne emer te sektorit.



2. **MICROFINANCE CENTER** – me qender ne Poloni- institucion i cili promovon dhe mbeshtet: ekonomine sociale, digjitalizimin, microfinancen e gjelber dhe financimin e qendrueshem dhe me ndikim.



3. **SHOQATA MIKROFINANCA SHQIPTARE** - Shoqata Mikrofinanca Shqiptare bashkon institucionet financiare jo bankare me te konsoliduara, me aktivitet kryesor mikrofinancen, te cilat se bashku perfaqësojne nje portofol kredie prej 29 miliarde lekesh (rreth 235 milion EUR), me me shume se 177,000 kliente aktive (shifrat e fundvitit 2019).



4. **SHOQATA E INVESTITOREVE TE HUAJ (FIAA)** - eshte shoqata me e rendesishme e biznesit ne Shqiperi, qe vepron kryesisht si mbeshtetese dhe lehtesuese e investitoreve te huaj ne vend.



5. **DHOMA AMERIKANE E TREGTISE** - Qellimet dhe objektivat kryesore te Dhomes Amerikane te Tregtise jane zhvillimi i marredhenieve ekonomike me perfitim reciprok midis SHBA-se dhe Shqiperise; te zhvilloje marredhenie te ngjashme ekonomike me Evropën dhe rajone te tjera; per te nxitur zhvillimin ekonomik vendor dhe per te dhene kontribute te tjera ne dobi te Shqiperise dhe rajonit te Ballkanit;



NOA gjithashtu ka **partneritet** dhe **bashkepunime** me shume institucione nderkombetare, kombetare, donator te ndryshem si dhe fonde te ndryshme garancie dhe huadhenes te nje niveli te larte:

1. Skema Kombetare e Garancise se Bujqesise e menaxhuar nga BERZH
2. Albanian Development Guarantee Foundation (ADGF) – e themeluar dhe menaxhuar nga KfW
3. Fondi i Garancise EaSI i menaxhuar nga EIF (Fondi European I Investimeve)
4. Programi CATALYZE EoG (Engine of Growth) nga USAID
5. EU Challenge fund for Start-Ups
6. Partneritet dhe bashkepunim me Universitetin Bujesor te Tiranes
7. Frankfurt School of Finance & Management



Albanian Development Guarantee Foundation



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE



European
Commission

EaSI Technical Assistance

**INNOVATION
CHALLENGE FUND**



NOA eshte akredituar dhe Certifikuar nga:

1. Kodi Evropian i Sjelljes se Mire per Sigurimin e Mikrokredive
2. Microfinanza Rating dhe

An initiative funded and supported by the European Union



3. TUV Austria – per manaxhimin e sigurise se informacionit ne marketing, identifikimin e klientit, aplikim, verifikim, disbursim, pagesa, dhe veprime te tjera ne funksion te veprimtarise financiare te kompanise, qe u jepet te gjithë klienteve per te gjitha segmentet dhe te gjitha kanalet e shitjes.

VIZIONI YNE, GJITHCKA NE SHERBIM TE KRIJIMIT TE VENDEVE TE PUNES, RRITJES SE MIREQENIES DHE AKSESIT NE FINANCE PER ÇDO SHQIPTAR

FINANCIM



- * Çdo sipërmarrës, fermer apo individ
- * Deri ne 1 Million lek për çdo lloj natyre financimi, vendimarrje për 1 orë
- * Pa burokraci, dhe me kolateral fleksibel deri në 3 milion Lek të reja.
- * Procedurat të shpejta edhe për vlera deri në 20 milion Lek

* Fermer apo sipërmarrës, pavarësisht produktit që tregton, mund të përfitojë nga shërbimi i partneritetit me NOA, me qëllim rritjen e shitjeve.



PARTNERITET

KËSHILLIM



- * Këshillimi financiar i klientin në çdo fazë të marrëdhënies me NOA,
- * Fokus dytësor rritja e prodhimit dhe promovimi i praktikave te mira.
- * Ekspertizë profesionale dhe komunikim i drejtëpërdrejtë me klientët



MBESHTETJA E KRIJIMIT TE VENDEVE TE PUNES DUKE INVESTUAR NE SIPERMARRJE PERMES FINANCIMIT TE BIZNESIT TE VOGEL DHE BUJQESISE

Në një vend postkomunist si Shqipëria, NOA ka mbështetur me sukses tranzicionin drejt ekonomisë së tregut dhe sipërmarrjes së më shumë se 100.000 individëve që nga viti 1998.



- Financim për zgjerimin e bizneseve në fushën e tregtisë, shërbimeve, turizmit etj. duke ruajtur një proces shumë të shpejtë dhe fleksibël disbursimi;
- Mbështetja e sipërmarrjeve micro përmes përshtatjes së procedurave të kolateralit
- Kohët e fundit është zgjeruar në financimin "Start-up"



- Mbështet fermerët dhe agrobizneset në investimet e tyre, rinovimin e kulturës, futjen e teknologjive të reja etj.
- Produkte financiare të dedikuara për skemat dhe certifikatat e granteve publike bujqësore;
- Fokus i veçantë në edukimin financiar të fermerëve



RRITJA E STANDARDEVE TE JETESES SE FAMILJES PA RREZIKUAR FINANCAT E INDIVIDEVE DHE TE FAMILJEVE

Mirëqenia e individëve dhe familjeve janë ndër objektivat themelore të NOA-s, ndërkohë një fokus prioritar i jepet edhe produkteve të përshtatura.



Mbështetje për investime në efikasitetin e energjisë me qëllim rritjen e kursimeve dhe përmirësimin e kushteve të jetesës




Ofrimi i të gjitha mundësive për të gjithë individët dhe familjet për t'u bërë pjesë e zhvillimeve të reja teknologjike




Mbështet cilësinë e jetës së familjeve shqiptare duke mbështetur transportin dhe rritjen e standardeve të tyre të jetesës.



MBESHTETJA E ZHVILLIMIT SOCIO-EKONOMIK TE VENDIT DUKE RRRITUR AKSESIN NE FINANCA



MIKRO-KREDIA, NJE INSTRUMENT FINANCIAR NE SHERBIM TE PAVARESIMIT EKONOMIK TE INDIVIDEVE DHE SIPERMARRJEVE



1.2 TRAJNIME



Si te pergatiteni: Trajtohuni dhe merrni mentorim



Per te percaktuar dhe "treguar" jo vetem projektin tuaj, por edhe ndikimin qe deshironi te arrini (ekonomik, mjedisor, social)

Si dhe  Çfare te kerkoni (dhe ku?!)

1.3 PREZANTONI DHE SHPERNDAJENI TEK TE TJERET PROJEKTIN TUAJ

Percaktoni qarte projektin, modelin e biznesit,
planin "industrial", misionin dhe përfaqësimin e
ekipit!

KRIJOJE → **MOTIVO** → **TREGOJE**



2. MUNDESITE PER SIPERMARRËSIT TE CILAT JANE TE LIDHURA ME PROGRAMIN

2.1 EYE ALUMNI NETWORK

(<https://www.erasmus-entrepreneurs.eu/alumni/>)



Pasi te keni perfunduar programin e shkembimit do te keni mundesi per te treguar dhe ndare eksperencen tuaj duke u bashkuar me rrjetin Alumni EYE.

Ky eshte nje sherbime i dedikuar posaçerisht per Alumni dhe ish pjesemarrësit e programit.

An initiative funded and supported by the European Union



Duke u regjistruar ne kete platforme ju do te mund te merrni informacione te rendesishme dhe perditesimet me te fundit per sipermarresit, duke perfshire evenimentet e dedikuara per sipermarresit e rrinj te cilat lidhen me veprimtarine dhe sektorin ne te cilin ju operoni, por me e rendesishmja ju do te keni mundesi rrjetezimi me profesioniste dhe sipermarres te cilet kane qene pjese e projektt dhe programit.

2.2 ENTERPRISE EUROPE NETWORK

[\(https://een.ec.europa.eu/\)](https://een.ec.europa.eu/)



Rrjeti European i Ndermarrjeve (EEN) ndihmon bizneset ne aspektin e novacionit dhe te rriten ne shkalle nderkombetare. Eshtë rrjeti me i madh mbeshtetes ne bote per ndermarrjet e vogla dhe te mesme (SME) me ambicie nderkombetare.

Rrjeti eshte aktiv ne mbare boten. Ai mbledh se bashku eksperte nga organizatat anetare qe jane te njohura per persosmerine e tyre ne mbeshtetjen e biznesit.


Organizatat anetare perfshijne:

- dhomat e tregtise dhe industrise
- organizatat e zhvillimit rajonal
- universitetet dhe institutet kerkimore
- agjencite e inovacionit

Bizneset individuale nuk mund të behen anetare te Rrjetit, por mund te perfitojne nga sherbimet e shumta te ofruara nga EEN.



Shifrat aktuale te rrjetit EEN jane si ne tabelen me poshte:



Rrjeti EEN eshte prezent edhe ne Shqiperi nepermjet te pese organizatave te cilat jane pjese e ketij rrjeti:

- Dhoma e Tregtise dhe Industrise – Durres
- Dhoma Ekonomike e Grave te Shqiperise
- Agjencia Kombetare e Kerkimit Shkencor dhe Inovacionit
- Agjencia Rajonale e Zhvillimit te SME
- Qendra per Promovimin e Konkureshmerise

3. ZHVILLIMI I QENDRUESHEM I NJE BIZNESI

Nje strategji e qendrueshme biznesi eshte nje strategji biznesi qe perfshin faktoret ekonomike, mjedisore dhe sociale ne politikat, praktikat dhe proceset e nje organizate per te krijuar perfitime afatgjata per organizaten dhe punonjesit e saj duke qene te ndergjegjshem per ruajtjen dhe mbrojtjen e burimeve.

3.1 KLIMA E TE BERIT BIZNESIT DHE MBESHTETJA PER NVM-TE NE SHQIPERI

Gjate viteve te fundit, Shqiperia ka ndermare nje sere reformash per te ulur barrierat administrative dhe permiresuar klimen e biznesit. Siç konfirmohet nga Renditja e Bankes Boterore per lehtesinë e te berit biznes, eshte bere progres ne drejtim te rritjes se aksesit ndaj kredive dhe forcimit te procedurave per zgjidhjen e paafetise paguese. Gjithashtu, Shqiperia e ka lehtesuar procesin e lidhjes me

An initiative funded and supported by the European Union




rjetin e energjise elektrike, zbatimin e lejeve te ndertimit dhe pagesen e taksave. Shqiperia u rendit e 82-ta nga 190 vende pjese e raportit per lehtesine e te berit biznes te vitit 2020, duke u renditur me lart se Bosnia dhe Hercegovina (90) por me poshte se Maqedonia e Veriut (17), Serbia (44), Mali i Zi (50) dhe Kosova (57). Totali i pikeve ishte 67.7, me nje rritje prej 7.2 pike krahasuar me raportin e vitit 2016, ku Shqiperia u rendit e 97-ta.

Tabela 1 Piket dhe renditja ne raportin Lehtesia e te Berit Biznes

Tregues	Raporti 2016		Raporti 2020	
	Piket	Renditja	Piket	Renditja
Nisja e nje biznesi	90.1	58	91.8	53
Zbatimi i lejeve të ndertimit	0.0*	189	52.7	166
Lidhja me rrjetin e energjisë elektrike	43.7	162	71.0	107
Regjistrimi i pronës	58.5	107	63.4	98
Marrja e kredise	65.0	42	70.0	48
Mbrojtja e investitoreve ne minorance	73.3	8	46.0	111
Pagesa e taksave	62.0	142	65.2	123
Tregtia pertej kufijve	91.6	37	96.3	25
Zbatimi i kontratave	57.4	96	53.5	120
Zgjidhja e paafetise paguese	63.4	42	67.7	39

Burimi: Banka Boterore, Lehtesia e te bërit biznes ne Shqiperi 2016/2020

Vizioni eshte te krijohet nje ekonomi shqiptare konkurruese, e nxitur nga inovacioni dhe e bazuar ne njohuri, e cila krijon vende pune te reja dhe me cilesore, duke shfrytezuar mundesite qe ofron transformimi i zinxhirit te vlerave nderkombetare, me theksin mbi zhvillimin e qendrueshem, ne integrimin Evropian dhe ate rajonal.



3.2 NEVOJAT DHE BURIMET E FINANCIMIT, PERGJEGJESITE DHE AFATET PER SIPERMARRJET NE SHQIPERI

Aktivitetet	Përgjegjësitë	Afatet	Nevojat për financim(million lekë)	Burimet e financimit(million lekë)	
				shtetërore	Ndërkombëtare (hendeku financiar ngj të kuqe)
Promovimi /lehtësimi sistematik i investimeve të synuara	<u>AIDA</u> , MFE, MEFA, MIE, MTE, MARD, dhomat dhe shoqatat e biznesit	Në vazhdim	30.8	16.3	14.5
Program i strukturuar për shërbimin e përkujdesjes së mëtejshme	<u>AIDA</u> , MFE, bashkitë, dhomat dhe shoqatat e tregtisë	Në vazhdim	-	-	-
Vlerësimi dhe reforma e programit të TEDA-ve	<u>MFE</u> , Korporata Shqiptare e Investimeve	2021-22: Vlerësimi 2022-27: Zbatimi	11.8	-	11.8
Programi i zhvillimit të ofruesve	<u>AIDA</u> , MFE	2022-24: Faza Pilot 2025-27: Zbatimi i plotë i programit	62.0	7.2	54.7
Strategjinë e Eksportit	<u>MFE</u> , AIDA, KKL, Dhomat e Biznesit	2022	0.1	0.1	-
Iniciativa e zhvillimit të biznesit elektronik	<u>MFE</u> , AIDA, Dhomat e Biznesit	2021-24	49.2	46.2	3.0
Skema për mbështetjen e sipërmarrjes me bazë konkurrencën	<u>AIDA</u> , MFE, KM, MBZHR, MTM	Në vazhdim	675.6	140.1	534.1

Aktivitetet	Përgjegjësitë	Afatet	Nevojat për financim(million lekë)	Burimet e financimit(million lekë)	
				shtetërore	Ndërkombëtare (hendeku financiar ngj të kuqe)
Fuqizimi i ekosistemit të start-upeve	<u>MFE</u> , MIE, MTM, MZHBR, Agjencia për Mbështetjen e Startup-eve, Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, inkubatorët, përsheptuesit dhe organizatat e mbështetjes së mëtejshme	Në vazhdim	1,678.4	74.75	1,603.67
Integrimi ndërkombëtar i ekosistemit të startup-eve	<u>MFE</u> , (planned) Agjencia e Start-upeve	Në vazhdim: Diaspora mentorship initiative 2024-27: Regional startup initiative	61.6	-	58 3.62 (international)
Nisma për përmirësimin e zinxhirit të vlerave me bazë konkurrencën	AIDA, MFE, MASR etj dhe organizata të tjera mbështetëse	2022-24	367.0	-	367.0
Rritje e aksesit në financë për NMVM-të	<u>MFE</u> , AIDA	Në vazhdim	6,451.66	6,446.49	5.1
Program për aftësitë sipërmarrëse për NVM-të	MFE, AIDA, AKPA, dhomat dhe shoqatat e tregtisë	Në vazhdim që prej 2022	37.36	37.36	-
Skema e mbështetjes për zhvillimin e kapitalit njerëzor bashkëpunues	<u>NASRI</u> , AIDA, MFE, MESY	2023-27	108.0	-	108.0




Aktivitetet	Përgjegjësitë	Afatet	Nevojat për financim(million lekë)	Burimet e financimit(million lekë)	
				shtetërore	Ndërkombëtare (hendeku financiar ngj të kuqe)
Program për zhvillimin e fuqisë punëtore për dhe me NVM-të dhe investitorët	AIDA, MFE, AKPA, bashkitë, qendrat e trajnimit, dhomat e biznesit dhe shoqatat	Në vazhdim	60.9	60.9	-
Sistemi i parashikimit të nevojave për aftësi	AKPA, NAVETQ, MFE, MESY, chambers, associations, private sector	Në vazhdim	12.2		12.2
Vlerësim periodik i nevojave për trajnim	AIDA, MFE, AKPA, chambers, associations	Në vazhdim	-	-	-

3.3 ZHVILLIMI I SIPERMARRJEVE SOCIALE NE SHQIPERI DHE KRAHASIMI ME BE

Sipermarrja sociale po behet e njohur ne shume vende te botes, nderkohe ne Evrope te gjitha shtetet kane zhvilluar ne nivele te ndryshme kulturen dhe praktiken e sipermarrjes sociale. Impakti i SS-se ne ekonomine Evropiane vlen te studiohet sepse perafersisht 13,6 milione Evropiane jane te punesuar nga sipermarrjet sociale ne te gjithe Evropen (Komisioni Evropian, 2020). Qellimi social eshte i fokusuar kryesisht ne ofrimin e mundesive te punesimit per grupet e pafavorizuara, ofrimin sherbimeve baze te kujdesit, zgjidhjen e sfidave specifike te komunitetit, rritjen e gjithepershirjes, ofrimin e mundesive te barabarta, garantimin e qendrueshmerise dhe pjesemarrjes qytetare ose arritjen e nje ose disa prej qellimeve te zhvillimit te qendrueshem (Komisioni Evropian, 2020).


Shqiperia, nje nga gjashte ekonomite e Ballkanit Perendimor dhe pjese e rajonit te Mesdheut eshte nje treg i vogel evropian ne zhvillim, i cili eshte i fokusuar drejt zhvillimit teknologjik se bashku me nje ekonomi ne rritje. Ne Shqiperi ka novatore te rinj potenciale, qe me disa perpjekje te perqendruara duke perfshire ketu ofrimin e kapitalit fillestar dhe mentorimin e duhur, mund te krijojne nje oferte tregu me vlere. Megjithate iniciativat ne fushen e sipermarrjes sociale vazhdojne te jene shume te vogla. Nga nje studim i realizuar ne vitin 2022 nga Partneret Shqiperi per Ndryshim dhe Zhvillim me mbeshtetjen e Agjencise Italiane te Bashkepunimit per Zhvillim (AICS), ne kuader te projektit "RISE-ALB rezulton qe keto sipermarrje jane te shtrire sipas sektoreve perkates si ne grafikun me poshte:





Nderkohe nga shifrat e sipermarrjeve sociale te cilat jane te organizuara ne formen e sipermarrjeve fitimpruese rezulton qe pjesa me e madhe e te ardhurave te tyre vjen: shitjet (50% e SS-ve fitimpruese), grantet (33% e SS-ve fitimpruese) dhe huate (17% e SS-ve fitimpruese). Kuotat e anetaresise, skemat e investimeve dhe prokurimet publike jane nder burimet e te ardhurave nga te cilat shumica e SS-ve mund te gjenerojne te ardhura. Situata eshte pothuajse e njejte me subvencionet shteterore dhe investoret/engjejt e biznesit, nga te cilat 50% e SS-ve pjesemarrrese gjenerojne te ardhura te uleta-mesatare dhe gjysma tjeter e SS-ve nuk gjenerojne aspak te ardhura nga keto burime.

Bazuar ne studimin e siperpermendur sfidat kryesore te cilat pengojne rritjen e zhvillimit te sipermarrjeve sociale jane:



Aksesi ne finanaca vazhdon qe te jete sfida kryesore e sipermarrjeve sociale ne Shqiperi, i ndjekur nga rekrutimi i punonjesve dhe nivel i ulet i ndergjegjesimit te investitoreve. Keto sfida te sektorit jane te pranishme edhe ne Evrope. Per shkak te natyres specifike te sektorit, perfituesve qe u sherbejne dhe misionit social te SS-ve, investitoret i konsiderojne sipermarrjet sociale si investime me rrezik te larte te shoqeruara me nje norme me te ulet kthimi.

Trajtimi tatimor/fiskal dhe kuadri ligjor aktual jane sfida te tjera te cilat po ndikojne negativisht ne zhvillimin e sektorit ose nuk kane fare ndikim. Mungesa e iniciativave fiskale edhe per sipermarrjet sociale qe punesojne grupe te marginalizuara, e shoqeruar me paqartesine dhe kufizimet e kuadrit ligjor ne fuqi, vendosin nje pikepyetje te madhe ne zhvillimin e sipermarrjeve sociale në vend

3.4 MUNDESITE PER FINANCIM DHE FORMA TE TJERA TE MBESHTETJES PER SIPERMARRJET NE TERESI DHE SIPERMARRJET SOCIALE NOVATORE

Ekzistojne forma te ndryshme te mbeshtetjes qe u vihen në dispozicion te mikro-SME-ve, ndermarrjeve sociale dhe subjekteve të tjera:

- Subvencione/Grante (Ministri, agjenci te ndryshme, donator te huaj dhe vendas)
- Instrumenta te ndryshem financiar (kredi, garanci , fonde investimesh etj.)
- Prokurime (tendera te ndryshem qe shpallen me prokurim publik)
- Çmime te ndryshme (konkurse te ndryshme ku jepen cmime per publikime, mbeshtetje, marketing, promovim etj) etj.

Disa nga institucionet me te rendesishme te cilat ju vijne ne ndihme ne forma te ndryshme te mbeshtetjes financiare jane:

1. HORIZON EUROPE (https://research-and-innovation.ec.europa.eu/funding/funding-opportunities/funding-programmes-and-open-calls/horizon-europe_en)
2. DG FOR EMPLOYMENT, SOCIAL AFFAIRS AND INCLUSION (<https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/data/topicDetails/smp-cosme-2023-eenee-01.html>)



3. EUROPA CRFEATIVE (<https://culture.ec.europa.eu/funding/cultureu-funding-guide>)
4. MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE (<https://financa.gov.al/>)
5. AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TE INVESTIMEVE (<https://aida.gov.al/sq/>) - Fokusi i agjencise eshte te rrise konkurrueshmerine e sektorit privat, forcimin e potencialit eksportues te vendit, promovimin dhe mbeshtetjen e investimeve te huaja direkte ne Shqiperi, si edhe promovimin e potencialit turistik te vendit.

Si ndermjetes mes investitoreve të huaj dhe Qeverise se Shqiperise, AIDA siguron qasje në informacione te perditesuara, siguron nje menyre efikase te komunikimit me organet qeveritare dhe sherben si nje "One-Stop-Shop", duke mbeshtetur investitoret gjate gjithe procesit të investimit.
6. PROGRAMI CO- SOLVE – nga Pro Seed GIZ SHQIPERI (<https://www.giz.de/en/worldwide/294.html>)
7. EU4INNOVATION – mbeshtetur nga GIZ dhe Qeveria Suedeze- ofron grante dhe mbeshtetje me mentorim per startupe ne fushen e Inovacionit (<https://challengefund.euforinnovation.al/>)
8. MINISTRIA E SHTETIT PER MBROJTJEN E SIPERMARRJES- ofron mbeshtetje per startup-et, aceleratoret, lehtesuesit e startupeve dhe Universiteteve (<https://sipermarrja.gov.al/>)
9. AGJENCIAL PER ZHVILLIMIN RURAL DHE BUJQESOR- ofron mbeshtetje me skema te ndryshme kombetare per subvencionim si dhe fondet IPARD (<https://azhbr.gov.al/>)
10. DELEGACIONI I BASHKIMIT EVROPIAN NE SHQIPERI – (https://www.eeas.europa.eu/eeas/grants_en?s=214)
11. Ambasada dhe perfaqesi te huaja te ndryshme ne Shqiperi



3.5 MUNDESI ALTERNATIVE PER FINANCIM

Nder format e tjera te financimit te cilat mund ti vijne ne ndihme sipermarresve jane:

- 1. FINANCIM NGA INSTITUCIONET FINANCIARE JO BANKA-** Institucionet financiare jo-banka, te cilat e ushtrojne veprimtarine e tyre nen licensimin dhe mbikeqyrjen e Bankes së Shqiperise, ndahen në disa nen-grupe, te cilat konsistojne ne: a) institucione financiare jo-banka te kredidhenies; b) Institucione Financiare te mikrokredise; c) institucione financiare te qirase financiare dhe/ose faktoringut; d) institucione financiare jo-banka te pagesave; dhe e) institucione financiare jo-banka te emetimit te parase elektronike. Te gjitha keto institucione operojne ne tregun shqiptar nen Ligjin për Bankat në Republikën e Shqipërisë, dhe mbikeqyren kryesisht me te njejtin kuader rregullator si edhe bankat, me perjashtim te disave nga fushat e veprimtarise se tyre, siç eshte administrimi i rreziqeve apo perlllogaritja e mjaftueshmerise se kapitalit.

Ne fund te vitit 2021 sistemi financiar numeronte 35 subjekte financiare jobanka (IFJB) duke u shtuar me 5 (pese) subjekte ne raport me vitin 2020. Subjektet e licencuara jane Paysera Albania, E Reja, RPay, Soft & Solution per ushtrimin e veprimtarise se parase elektronike dhe Antigone Financial Enterprise per veprimtarine e qirase financiare.

Me poshte jane disa grafike me shifrat perkatese te cilat tregojne mbeshtetjen e ketyre institucioneve per bizneset dhe individet ne tregun Shqiptar sipas periudhave perkatese:

Ecuria e portofolit të kredisë mbi baza neto dhe bruto për totalin e SFJB-ve


Treguesi/mld lekë	Dhjetor 2018	Dhjetor 2019	Dhjetor 2020	Dhjetor 2021
Totali i portofolit të kredisë për IFJB-të (neto)	26.4	33.0	33.5	37.4
Totali i portofolit të kredisë për IFJB-të (bruto)	28.6	35.5	36.6	42.1

Burimi: Banka e Shqipërisë



Shifra te publikuara vetem nga anetaret e Shoqates AMA:

Grafik 4 – Vëllimi i kredisë së gjatë viteve 2018 – 2021
dhe ndarja sipas sektorëve të ekonomisë (shifrat në milionë Lekë)



Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare

2. CROWDFUNDING - Instrument financues që lejon kompanite të rrisin kapitalin në treg, duke përdorur alternativa ose kanale plotësuese të ndryshme nga ato tradicionale. Është një proces me të cilin disa njerëz kontribuojnë përmes përdorimit të portaleve të veçanta ose platformave të ndryshme, shuma parash për të financuar një projekt të caktuar.

Ekzistojnë forma të ndryshme të crowdfunding:

- Crowdfunding kreditimi (ose kreditimi social)
- Financim kapitali
- Bazuar në shperblime
- Bazuar në donacione

3. INVESTIME ME NDIKIM: Investimi me ndikim është një aktivitet investimi në kompanite, organizatat dhe fondet që funksionojnë me qëllim të gjenerimit të një ndikim pozitiv social dhe mjedisor, i cili është e matshme dhe në përputhje me kthimin ekonomik.

Krahasuar me investimet tradicionale, investimet me ndikim marrin në konsideratë dimensionin e ndikimit: ata vleresojnë se cilat janë pasojat e një aktiviteti ekonomik mbi njerëzit dhe në planet dhe drejtojnë ndarjen e burimeve ekonomike drejt atyre aktiviteteve të cilat jo vetëm që nuk janë

te demshme, por qe gjenerojne qellimisht nje rezultat social dhe mjedisor pozitiv.

- 4. KAPITALI PRIVAT DHE KAPITALI SIPERMARRES** - Kapitali privat eshte kapitali i investuar ne nje kompani ose njesi tjeter qe nuk eshte i listuar ose tregtuar publikisht. Kapitali sipermarres (Venture Capital) eshte financimi i dhene per startup-et ose bizneset e tjera te reja qe tregojne potencial per rritje afatgjate. Kapitali sipermarres (VC) eshte nje forme e kapitalit privat dhe nje lloj financimi qe investoret ofrojne per kompanite start up dhe bizneset e vogla qe besohet se kane potencial rritjeje afatgjate. Kapitali sipermarres ne pergjithesi vjen nga investitore te pasur, banka investimesh dhe çdo institucion tjeter financiar.



Dega NOA



068 400 1403



noafin.al



noa.financojme

Historiku i dokumentit

Nr. i rishikimeve	Data	Pershkrimi i ndryshimeve	Autori/Bashke- autori
1.0	07/2023	Versioni fillestar	Valbona Elmazi – Menaxher Projekti, NOA Sh.a

